



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, datë 17. 05. 2019

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA VORË

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Vorë Nr. 23 datë 28.02.2019 “Mbi miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor”, me propozimin e Bashkisë Vorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vorë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Vorë, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.



Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.

4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Vorë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Vorë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Vorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
 - Vendim i KRRTRSH-së Nr. 15 datë 21.07.2009 “Detyrë Projektimi për Studimin Rajonal dhe Mjedisor të Rajonit që përfshin Bashkinë Vorë, Komunën Prezë, Komunën Bërxullë”;
 - Vendim i KRRTRSH-së Nr. 16 datë 21.07.2009 “Masterplani i Bashkisë Vorë, Detyra e Projektimit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Vorë, Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Vorë”;
 - Vendim i KKT-së Nr. 22 datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor”, Bashkia Vorë, Qarku Tiranë;
 - Vendim i KKT-së Nr. 15 datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Bërxull, Qarku Tiranë.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



MINISTËR I LINJËS

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

